

Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës (FKPK) është institucion i pavarur, i themeluar për ta administruar sistemin e kursimeve të obligueshme pensionale në Kosovë, dhe vepron në kuadër të Ligjit Nr. 04/L-101 për fondet pensionale në Kosovë dhe me plotësimet e mëtutjeshme të këtij ligji. FKPK-ja, në përputhje me nenin 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 e shpall këtë:

## KONKURS PUBLIK

për plotësimin e pozitës me të dhënat si në vijim:

**Titulli i pozitës:** ZHVILLUES I PROGRAMEVE DHE BAZËS SË TË DHËNAVE (DY POZITA)

Numri i referencës: **KON032025**  
Kohëzgjatja e emërimit: Sipas marrëveshjes dhe nevojave të FKPK-së  
Adresa: Rr. "Agim Ramadani" Nr. 182-184, 10000 Prishtinë

### Detyrat dhe përgjegjësitë:

Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës përkushtohet në avancimin teknologjik dhe përmirësimin e vazhdueshëm në ofrimin e shërbimeve të saj. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të pozitës së zhvilluesit të programeve dhe bazës së të dhënave përfshijnë:

- Mirëmbajtjen, optimizimin dhe përmirësimin e sistemit bazë dhe intranetit të FKPK-së.
- Bashkëpunimin e ngushtë me palët e brendshme për të zhvilluar funksionalitete të reja.
- Shkrimin, testimin dhe optimizimin e kërkesave komplekse në SQL dhe procedurave e funksioneve në PL/SQL.
- Administrim i bazës së të dhënave.
- Identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve të lidhura me bazën e të dhënave dhe defekteve të sistemit.
- Mbështetjen në ndërlidhjen e duhur të aplikacioneve online të FKPK-së me bazën e shënimeve.
- Sigurimin e integritetit dhe sigurisë së të dhënave brenda sistemit.
- Testimin e aplikacioneve të FKPK-së dhe mirëmbajtjen e dokumentacionit teknik për proceset dhe ndryshimet e sistemit.
- Analizimin e ndikimit në mes të programeve, p.sh., nëse një ndryshim në një pjesë të një programi do të shkaktonte rezultate të padëshiruara në një pjesë tjetër të ndërlidhur.

### Kandidati ideal duhet të ketë:

- Kuptim të qartë të koncepteve të bazave, relacionale të dhënave dhe arkitekturës së bazës së të dhënave.
- Përvojë në zhvillim në Oracle PL/SQL dhe administrimin e bazave të dhënave Oracle.
- Aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe bashkëpunuese në një mjedis dinamik.
- Aftësi të forta analitike për zgjidhjen e problemeve.
- Aftësi të shkëlqyera në komunikimin me shkrim dhe verbal.

### Kriteret:

**Edukimi:** Preferohet niveli baçelor ose më i lartë në shkenca kompjuterike.

**Përvoja:** Preferohet përvojë në zhvillim me Oracle APEX, dhe njohuri mbi teknologjitë e uebit (HTML, CSS, JavaScript) dhe .NET.

### Afati dhe mënyra e konkurrimit:

- Konkursi është i hapur prej **18 shkurtit deri më 10 mars 2025 23:59 (CET)**.
- Aplikimi bëhet vetëm përmes email-it në adresën: **recruitment@trusti.org**, me referencë: **"Zhvillues i programeve dhe bazës së të dhënave"**
- Email-it duhet t'i bashkëlidhen edhe dokumentet në vijim: biografia (CV-ja), letërmotivimi dhe diploma e certifikatat profesionale (nëse ka).

### Informim paraprak:

Aplikacionet që nuk i kanë të bashkëngjitura dokumentet e lartcekura (së paku CV dhe letërmotivimi) NUK do të shqyrtohen! Vetëm kandidatët që i plotësojnë kushtet e konkursit do të kontaktohen.

**FKPK-ja është punëdhënës që ofron mundësi të barabarta për të gjithë!**